



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 31 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme Nr. 1370, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar për Bashkëpunim
Numri i referencës:	ZPB/ZKA/14-08/23
Grada:	ZKA-B4
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen funksionin ndërlidhës në të gjitha aktivitetet në mes të Kuvendit dhe ZKA-së;
- Zhvillon bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës në fushën e komunikimit dhe informimit lidhur me çështje për ZKA-në;
- Angazhohet me Kuvendin dhe Komisionet parlamentare për ngritjen e vetëdijes për rolin e ISA/ZKA;
- Bashkëpunimi me Komisionet parlamentare me qëllim të ndërgjegjësimit të palëve të interesit për ngritjen e transparencës dhe të llogaridhënies;
- Koordinon dhe ofron mbështetje për pjesëmarrjen e nëpunësve të ZKA-së në Komisionet parlamentare;
- Koordinon aktivitetet për përgatitjen e dokumentacionit për Komisionet parlamentare;
- Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me palët përgjegjëse në përgatitjen e marrëveshjeve, memorandumeve me Kuvendin dhe komisionet e Kuvendit;
- Përgatitë raporte përmbledhëse për mbledhjet e komisioneve;
- Përgatit raport vjetor për raportet e shqyrtuara në Kuvend;
- Përcjell rekomandimet e dala nga Komisionet që kanë të bëjnë me ZKA-në;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e komunikimit.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë të bashkëpunimit me palë të jashtme;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **08.09.2023 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.